



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 22.01.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË**  
**PRISHTINËS**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prishtinës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i Ekipit Luljeta Sylaj dhe Anëtarët Syeda Oruqi dhe Ardita Salihu, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Zukë Zuka.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	31
5 Qeverisja e mirë.....	32
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	35
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	37
Shtojca III: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit.....	47
Shtojca IV: Letër konfirmimi .....	48

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Prishtinës, për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 04.10.2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës së Prishtinës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

#### **Theksimi i çështjes**

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 1,823,140€ ishin realizuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Pjesa më e madhe e tyre ishin të buxhetuara gabimisht si investime kapitale.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**

Theksimi i Çështjes pasqyron dobësitë në kontrolle për ta konfirmuar klasifikimin e drejtë të shpenzimeve.



Kryetari duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV 2017 përfshinë një rishikim përfundimtar të menaxhmentit përgjegjës, dhe deklarata për PFV-të të nënshkruhet vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih kapitullin 2).

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit, tek projektet kapitale mbetet sfida kryesore për komunën. Ata kishin realizuar vetëm 57% të buxhetit në këtë kategori.



Kryetari duhet të aplikojë një vlerësim të detajuar të menaxhimit të projekteve kapitale dhe të prokurimit për t'i identifikuar arsyet për një realizim kaq të ulët dhe të marrë veprimet e nevojshme për të përmirësuar gjendjen e tyre në vitin 2018. (shih çështjen 2 - 3).

Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme ishin efektive, mangësi janë vërejtur në disa sisteme të rëndësishme financiare, si të hyrat, shpenzimet dhe llogaritë e arkëtueshme.



Kryetari duhet të aplikojë një vlerësim të detajuar të menaxhimit të fushave brengosëse të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet e paraqitjes së mangësive dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. (shih çështjet nga 4 deri 21).

Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohet ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Kryetari duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjen 23).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial kanë shënuar progres, mirëpo ka hapsirë të zhvillohen më tutje. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm nuk ishte funksional për të mbështetur zhvillimet në këtë fushë.



Kryetari duhet të sigurojë që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për ta ngritur efektivitetin operativ të mbështetur nga një NjAB më efektive (shih çështjet 24 dhe 25).

**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Komenti i Kryetarit të Komunës për çështjen që nuk jemi pajtuar, është dhënë në detaje në Shtojcën III.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e komunës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e saj se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet për mallra dhe shërbime (për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara, dezinfektimin e objekteve, naftë për ngrohje e të ngjashme, si dhe pagesa të ekzekutuara nga thesari për shpenzime të ndryshme operative) janë paguar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Vlera totale e tyre është 1,823,140€, ku prej tyre 1,571,267€ kishin qenë gjithashtu të buxhetuara gabimisht. Shpenzime të tilla kanë ndodhur edhe vitet e mëhershme. Sipas komunës këto janë pasojë e buxhetit të kufizuar për mallra dhe shërbime e të cilat janë të domosdoshme, andaj edhe janë aprovuar me ligjin e buxhetit.

Pavarësisht arsytimit të prezantuar, sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik këto konsiderohen shpenzime operative dhe do të duhej të paguhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

## Çështjet kyçe të auditimit

Çështjet të cilat në gjykimin profesional të auditorit paraqesin rëndësi të veçantë për auditimin e PFV-ve janë çështjet që komuna duhet adresuar në kontekst të auditimit të PFV-ve si tërësi. Në këtë aspekt ne paraqesim çështjen e pagesave për projektet me bashkëfinancim:

- Vitin e kaluar, ne kemi raportuar për transferet<sup>1</sup> e parave që ka bërë komuna në bazë të marrëveshjeve me donatorë apo ndërmarrje publike dhe kemi rekomanduar që marrëveshjet për projektet e bashkëfinancuara të kenë një siguri për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, përfshirë kërkesat e qarta të raportimit gjatë zbatimit dhe monitorimit të projektit para se të bëhen transferet e mjeteve. Megjithatë, transferet në formën e njëjtë janë bërë edhe në vitin 2017. Komuna ka nënshkruar marrëveshje me Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA) për zbatimin e projektit “Iniciativa për qëndrueshmëri ekonomike rurale” për subvencionim të fermerëve të rajonit të Prishtinës. Projekti është tre vjeçar, me participim 1,500,000€ nga komuna dhe 337,425€ nga ADA. Derisa zbatues i projektit ishte zgjedhur Care Osterreich<sup>2</sup>, të cilës në shtator 2017 komuna i ka transferuar vlerën 476,518€ nga të cilat vetëm 35,450€ janë shpenzuar për gjashtë fermerë. Mjetet e lira prej 441,068€ kanë mbetur në llogari të Care Osterreich, të cilat pritet për t'u transferuar në momentin kur fermeri përmbushë kushtet e paracaktuara. Ne do të përcjellim në vazhdimësi zbatimin e projektit për të konstatuar nëse donatori po respekton marrëveshjen dhe obligimin për bashkëfinancim si dhe nëse komuna po deklaron saktë shumat që donatori paguan tek përfituesi, si palë të treta;
- Llogaritë e arkëtueshme të komunës po vazhdojnë të jenë të larta edhe në vitin 2017. Prej tyre 10,581,792€ janë të arkëtueshme nga tatimi në pronë nga ndërmarrjet shoqërore të cilat administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), e që kjo përbën 21% të totalit. Vlera prej 1,458,016€ janë të arkëtueshme të ndërtesës qeveritare ish “Rilindja” e cila që nga viti 2008 shfrytëzohet si objekt qeveritar dhe është shpronësuar në vitin 2013. Vetëm

<sup>1</sup> Pagesat ndaj OJQ-ve “Gratë në Biznes për realizimin e projektit të tregut mobil të fermerëve”, “Help-Hilfe për mbështetje, stabilitet socio-ekonomik përmes fuqizimit të sektorit të mikrobiznesit në Kosovë” dhe “Trafiku Urban (IVECO) për blerjen e autobusëve”.

<sup>2</sup> Me përfaqësuesin e saj për Ballkan, Care International Kosova.



nga viti i shpronësimit ky borxh është 238,132€. Sipas komunës, kjo çështje është në shqyrtim në aspektin ligjor dhe sipas rezultateve përfundimtare do të trajtohet këtë vit<sup>3</sup>; dhe

- Çështja e menaxhimit të pasurisë ende mbetet sfiduese, ngase pasuria e trashëguar dhe ajo e pranuar si donacion ende nuk është e regjistruar tërësisht në librat kontabël të pasurisë.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV**

Kryetari i Komunës së Prishtinës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

<sup>3</sup> Sipas ligjit për tatimin në pronë objektet qeveritare dhe ato që janë në posedim të qeverisë janë të liruara nga tatimi në pronë;

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e ligjeve Organike për Qeverisje Lokale;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Raportet tremujore duke përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Raportet dhe faturat e papaguara; dhe
- Planin e prokurimit dhe raportin për kontratat e nënshkruara publike.

Në kontekst të PFV-ve, këshillat që i kemi dhënë në Memorandumin e Auditimit ishin adresuar gjatë procesit të përgatitjes së tyre. Por sfida edhe më tutje mbetet angazhimi i Zyrtarit Kryesor Financiar.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Përpos çështjeve të theksuara të opinionit të auditimit ne kemi identifikuar gabime edhe të shpalosja e obligimeve, neni 17, të cilat ishin të mbivlerësuar në total për 10,335€. Fillimisht ishin mbivlerësuar për 76,415€, si pasojë e dy lëndëve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit të cilat ishin paguar gjatë vitit 2017 mirëpo ishin raportuar gabimisht si obligim në PFV, ndërsa në anën tjetër ishin nënvlerësuar për 66,080€ si pasojë e mos deklarimit të katër faturave të papaguara.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Në lidhje me të gjeturat e lartcekura ne japim rekomandimin në vijim:

**Rekomandimi 1** Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e theksuara në opinionin e auditimit dhe te çështjet kyçe. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të obligimeve të papaguara.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, llogaritë e arkëtueshme si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Prishtinës në përgjithësi ka të vendosur sistem relativisht të mirë të kontrolleve në raport me obligimet e saj statutores. Megjithatë, edhe me tutje mbesin disa fusha të cilat kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Derisa kontrollet mbi realizimin e të hyrave dhe investimeve duhet të shtohen me qëllim që komuna të realizojë ato në një përqindje më të lartë kundrejt mundësive të saj. Përveç kësaj nevojitet një përqendrim më i shtuar i komunës në parandalimi i ekzekutimit të pagesave direkte nga thesari.

Vlen të theksohet se rreth 43% e buxhetit të investimeve kapitale ishte shpenzuar në tremujorin e fundit, derisa vetëm në dhjetor ishin shpenzuar 4,109,762€ apo 23% e total shpenzimeve. Kjo paraqet një tregues se të projektet kapitale ka vonesa si në kryerjen e punëve ashtu edhe tek proceset e prokurimit. Me tutje fushat tjera ku nevojiten përmirësime të mëtejshme përfshijnë menaxhimin e personelit, subvencionet, mallrat dhe shërbimet, investimet kapitale, pasuritë dhe obligimet.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>4</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>62,023,630</b>	<b>71,288,276</b>	<b>57,049,572</b>	<b>58,774,749</b>	<b>64,525,481</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	37,416,255	37,494,011	37,411,514	35,638,815	35,573,654
Të bartura nga viti paraprak <sup>5</sup> -	-	8,746,590	3,041,711	6,382,842	16,383,352
Të hyrat vetjake <sup>6</sup>	24,319,875	24,319,875	16,230,271	16,394,896	12,265,988
Donacionet e brendshme	-	1,615	-	10,699	4,700
Donacionet e jashtme	-	189,927	123,345	347,497	297,787
Të hyra nga huamarrjet	287,500	536,258	242,731	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 12% apo 9,264,647€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 8,746,590, e cila bartje ishte aprovuar nga Kuvendi Komunal në dhjetor të vitit 2016, nga granti i qeverisë 77,756€ për mbulimin e pagave, donacionet e jashtme dhe të brendshme 191,542€, si dhe nga huamarrja e Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) 248,758€ që kishte të bënte me performancën në shëndetësi.

Për vitin auditues komuna ka shpenzuar 80% të buxhetit final, në shkallë të njëjtë krahasuar me vitin 2016. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>62,023,630</b>	<b>71,288,277</b>	<b>57,049,572</b>	<b>58,774,749</b>	<b>64,525,481</b>
Pagat dhe Mëditjet	28,044,512	28,128,949	28,128,949	27,900,604	27,404,645
Mallrat dhe Shërbimet	7,637,910	7,963,454	7,834,544	7,418,324	9,008,155
Shërbimet komunale	1,793,000	1,793,000	1,776,482	1,791,297	2,079,910
Subvencionet dhe Transferet	1,816,810	1,916,810	1,506,072	1,655,659	1,621,155
Investimet Kapitale	22,731,398	31,486,064	17,803,525	20,008,865	24,411,616

<sup>4</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>5</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>6</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për kategorinë e investimeve kapitale ishte rritur për vlerën e të hyrave vetanake të vitit të kaluar. Pavarësisht rritjes së buxhetit, vetëm 57% e buxhetit të investimeve ishte shpenzuar. Përderisa Programi për Investime Publike përfshin 97 projekte, 30 prej tyre nuk ishin realizuar fare apo janë realizuar deri në shkallën 10%. Performanca e ulët është si rezultat i kërkesave të vonuara nga njësitë kërkuese për iniciimin e procedurave të prokurimit, ankesat e operatorëve të cilat kanë zgjatur afatin deri te nënshkrimi i kontratave, vonesat e realizimit të punëve nga kompanitë dhe moszgjdhja me kohë e çështjeve pronësore;

Nga raporti i kontratave të nënshkruara shihet se 80% e kontratave me vlerë të mesme/madhe janë nënshkruar në gjashtëmujorin e dytë të vitit, që është edhe një tregues se realizimi i punëve dhe pagesat mund të mbesin për vitin pasues. Megjithatë, vonesat në zbatim janë gjithashtu të dukshme në disa projekte të filluara para vitit 2017;

- Buxheti për paga dhe mëditje ishte rritur për 84,436€, kjo rezulton nga vendimi i Qeverisë i marrë në dhjetorin 2017, përmes të cilit ky buxhet është rritur për 77,756€ për të mbuluar deficitin e buxhetor të kësaj kategorie. Kjo mungesë buxheti është shkaktuar nga ngritja e koeficienteve të punonjësve, si dhe nga kompensimi në shumën prej 29,898€ për një punonjës të suspenduar në vitin 2008 i cili kishte fituar rastin si palë paditëse ndaj komunës. Po ashtu edhe 6,682€ ishin shtuar nga grantet e donatorëve;
- Me rishikim të buxhetit, kategoria mallrave dhe shërbimeve kishte rritje të buxhetit në vlerë prej 325,543€. Vlera prej 248,758€ ishte nga huamarrja, e cila rrjedhë nga marrëveshja në mes të komunës dhe MSH-së. Po ashtu kësaj kategorie i janë shtuar edhe 76,785€ nga grantet e donatorëve të cilët kishin përkrahur projekte të ndryshme, lidhur me fushata, aktivitete dhe subvencionime fermerësh. Pavarësisht buxhetit rreth 1,8 milionë shpenzime për mallra dhe shërbime ishin paguar nga kategoria e investimeve kapitale;
- Buxheti për komunalitë nuk ka ndryshuar nga ai fillestar. Sa i përket këtij buxheti nuk kishte një planifikim të mirë, ngase njësitë vartëse të komunës nuk kishin arritur të paguajnë komunalitë në fund të vitit nga ky fond dhe shpenzimet ishin mbuluar nga mjetet e kategorive tjera ekonomike, përmes ekzekutimit të pagesave direkt nga thesari. Vetëm nga mostrimi ynë 404,764€<sup>7</sup> ishin paguar për shpenzime të ngrohjes- Termokosit;
- Kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve ishte rritur për 100,000€ mjete të cilat ishin alokuar nga të hyrat vetanake me vendimin e Kuvendit Komunal, me qëllim të subvencionimit të aktiviteteve kulturore dhe sociale; dhe
- Komuna gjatë vitit ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët e jashtëm në vlerën 191,542€, të cilat ishin alokuar për mallra dhe shërbime për të financuar mbështetjen e fushatave të ndryshme si për tatimin në pronë, këshillim në karriere, fermerët, etj. Ndërkohë që realizimi ishte 123,344€ dhe bartje për vitin tjetër ka mbetur vlera prej 68,198€.

<sup>7</sup> Pagesat për Termokosin nga kodi i investimeve kapitale 31121 në vlerë 264,084€, si dhe 140,679€ nga kodi 13610.

**Çështja 2 – Nivel i ulët i realizimit të buxhetit të investimeve kapitale**

- E gjetura** Ekzekutimi i ulët lidhur me investimet kapitale është sfida kryesore me të cilën përballlet komuna. Vetëm 57 % e buxhetit të kësaj kategorie është shpenzuar dhe çështja nuk është adresuar nga menaxhmenti në vitet e fundit edhe pse ajo është trajtuar në raportet e mëparshme të auditimit. Sipas komunës arsyet për një ekzekutim kaq të ulët të buxhetit lidhen me vonesat në realizimin e projekteve, inicimi dhe lidhja e kontratave me vonesë, dhe si rezultat i planifikimit jo të mirë të shpenzimeve.
- Rreziku** Ekzekutimi i ulët i investimeve kapitale do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion. Për komunën mos-përmbushja e programit për investime kapitale do të rezultojë në realizimin e më pak projekteve si dhe në cilësinë e shërbimeve.
- Rekomandimi 2** Kryetari, duhet të ndër marrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2017 dhe më herët si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018. Performanca buxhetore duhet të rishikohet në baza mujore për të identifikuar në vazhdimësi barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

**Çështja 3 – Pagesat përmes vendimeve gjyqësore**

- E gjetura** Thesari ka ekzekutuar pagesa sipas nenit 39.2 dhe 40 në vlerë prej 1,875,280€ nga buxheti i komunës direkt në llogari të Operatorit Ekonomik (OE). Nga testimet vërejtëm se për 28 pagesa të ekzekutuara sipas urdhërësave të përmbaruesve privat në vlerë 867,397€, komuna kishte paguar shpenzime shtesë në vlerë 36,755€, për përmbaruesit. Edhe pse nuk kemi marrë përgjigjen e kërkuar me shkrim, ekzekutimi i pagesave nga Thesari rrjedh si rezultat i hyrjes në obligime pa zotim paraprak të mjeteve, në mungesë buxheti, nga pranimi i shërbimeve me kontrata të skaduara, etj
- Rreziku** Format e pagesës përmes vendimeve gjyqësore rrezikojnë realizimin e projekteve të planifikuara kapitale nga ku janë marrë mjetet për pagesë, si dhe duke shkaktuar dëmtim shtesë të buxhetit për shkak të shpenzimeve përmbarimore. Po ashtu kjo formë e pagesës rritë rrezikun që operatori qëllimisht të mos i sjell faturat në mënyrë që të përfitojnë palët e përfshira.
- Rekomandimi 3** Kryetari, duhet të marrë veprimet e duhura në mënyrë që të ndërpresë praktikën e krijuara të pagesave me vendime gjyqësore ose pagesave direkte nga thesari. Shmangia e tyre duhet të bëhet duke respektuar me përpikëri rregullat e prokurimit publik (menaxhim i mirë të kontratave nga planifikimi, ekzekutimi e deri të raportimi i tyre), si dhe rregullat e thesarit lidhur me zotimin e mjeteve me kohë si dhe hapave tjerë deri në ekzekutimin e pagesave.

## 3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2017 ishin në vlerë 23,559,620€. Në këtë vlerë dominojnë të hyrat nga tatimi në pronë që përbën 30% të të hyrave të përgjithshme, pas tyre janë të hyrat nga lejet e ndërimit, kadastrit, të hyrat nga legalizimi i objekteve, taksat administrative, shfrytëzimi i hapësirave etj. Po ashtu komuna këtë vit ka pranuar edhe të hyra nga gjobat nga trafiku, gjykatat dhe agjencia e pyjeve në vlerë prej 892,998€ të cilat janë shpalosur në PFV.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
<b>Gjithsej të hyrat vetjake</b>	<b>24,319,875</b>	<b>24,319,875</b>	<b>23,559,620</b>	<b>24,243,686</b>	<b>18,035,992</b>
Tatimi në pronë	4,976,810	4,976,810	6,961,321	7,176,272	5,623,478
Taksa komunale	19,343,065	19,343,065	16,598,299	17,067,414	12,412,514

Në vitin 2017 nga të hyrat vetjake ishin alokuar 31,861,892€ për shpenzim nga të cilat ishin shpenzuar vetëm 60%. Derisa nga të hyrat e arkëtuara 13,034,228€ janë bartur për tu shpenzuar në vitin 2018. Në anën tjetër komuna kishte arritur të mbledhë 97% të të hyrave të planifikuara me buxhet.

Nga të hyrat vetjake të komunës mbulohen 34% të shpenzimeve totale të komunës, të cilat planifikohen të shpenzohen për rregullimin e infrastrukturës apo investime kapitale në kryeqytet dhe rrethinën e saj.

Auditimi ynë shpalosi disa mangësi për mënyrën e menaxhimit të të hyrave në komunë, si në vijim.

### Çështja 4 - Planifikim jo i mirë i të hyrave sipas kategorive

**E gjetura** Komuna ka arritur të realizojë pothuajse të gjitha të hyrat e planifikuara, me devijim vetëm 4%, megjithëse nëse i shohim ato sipas kategorive vërejmë dallime të mëdha. Fjala bie, për legalizimin objekteve ishin paraparë të mblidhen 4,000,000€<sup>8</sup> derisa ishin realizuar vetëm 2%, e njëjta kishte ndodhur edhe me të hyrat nga parkingu të cilat ishin realizuar vetëm 16%, kundrejt planit 2 milionësh.

**E gjetura** Planifikimi jo i mirë i të hyrave krahasuar me tendencat paraprake rrezikon ngecjen në realizimin e projekteve të planifikuara nga burimet vetjake dhe mos përmbushjen e objektivave të organizatës.

**Rekomandimi 4** Kryetari, duhet të sigurojë se bëhet një planifikim objektiv dhe të realizueshëm dhe i njëjti të duhet të përcillet me aktivitete dhe masa adekuate për zbatim.

<sup>8</sup>Planifikim joreal, kur ka qene i ditur afati i ligjit per legalizimine eshte me 05/02/2017



---

**Çështja 5 – Dhënia e pronave në shfrytëzim pa kompensim**

- E gjetura** Në vitin 2014 komuna kishte bërë verifikimin e të gjitha pronave komunale, në mesin e të cilave edhe ngastrat që janë në pjesën e quajtur “Zona Industriale”<sup>9</sup>. Të paktën 37 parcela të kësaj zone me rreth 6 hektarë, shfrytëzohen nga biznese të ndryshme pa asnjë kompensim ndaj komunës. Sipas Drejtorisë së Pronës në komunë, këtë vit ka filluar të shqyrtojë mundësinë e gjenerimit të të hyrave nga parcelat e kësaj zone.
- Rreziku** Lënia e pronave komunale në shfrytëzim të bizneseve pa marrëveshje/kontratë dëmton të hyrat e komunës dhe rrit rrezikun që shfrytëzuesit të manipulojnë me ato prona.
- Rekomandimi 5** Kryetari, duhet të rishikoj shkakun e shfrytëzimit të pronave pa kompensime dhe të marrë veprime për të nënshkruar marrëveshje me bizneset/shfrytëzues të pronave për kompensimin e tyre, qoftë përmes qirasë ose formave tjera ligjore.

**Çështja 6 - Nuk arrihet të verifikohet 1/3 e pronave të komunës**

- E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 së pronave të paluajtshme siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe UA në fuqi. Nga gjithsej 97,408 prona deri më tani komuna ka arrit të verifikoj vetëm rreth 23,521 sosh. Procesi i verifikimit është krejtësisht i ngjashëm me atë të regjistrimit për veç se nuk rezulton me regjistrim të një pronë të re mirëpo me përmirësimin e shënimeve ekzistuese.
- Rreziku** Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet t’i analizojë arsyet dhe pengesat se pse kërkesat ligjore në këtë fushë nuk janë zbatuar dhe të ndërmarrë veprime shtesë që të sigurojë se në vitin vijues do të bëhet verifikimi i pronave komunale ashtu siç parashihet me ligj.

---

<sup>9</sup> Pjesa në përfundim të qytetit të Prishtinës, përkatësisht në drejtim të Fushë Kosovës.

---

---

**Çështja 7 - (Mos) gjenerimi i të hyrave nga taksat në biznes**

- E gjetura** Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale parasheh ngarkesat vjetore për ushtrimin e disa nga veprimtaritë afariste të cilat operojnë në komunë. Drejtoria e Planifikimit Strategjik, e cila është e ngarkuar me këtë çështje nuk ka informata të sakta për numrin e veprimtarive afariste që janë të obliguara të paguajnë taksën komunale. Të hyrat nga kjo taksë mbështeten në deklarin vullnetar të bizneseve. Bizneseve të obliguara ndaj kësaj takse nuk iu është lëshuar faturë, njëkohësisht nuk figuron të jetë marrë ndonjë masë ndaj atyre që nuk kanë paguar. Në këtë vit nga kjo taksë janë mbledhur 68,180€, apo 18% më pak se vitin e kaluar kur ishin mbledhur 83,887€.
- Rreziku** Inkasimi i të hyrave bazuar në vullnetin e bizneseve dhe mungesa e të dhënave të sakta, ndikon direkt në uljen e të hyrave totale të komunës dhe në planifikim jo real të hyrave.
- Rekomandimi 7** Kryetari, të ndërmarrë masa rreth krijimit të një bazë të saktë për të gjitha bizneset që operojnë në komunë dhe janë obligues ndaj kësaj takse bazuar në rregulloren e nxjerrë në Kuvendin Komunal. Me tutje të sigurojë se bizneset faturohen në baza të rregullta dhe merren të gjitha veprimet e duhura për inkasimin e tyre.

**Çështja 8 - Regjistrimi dhe raportimi i të dhënave**

- E gjetura** Komuna nuk posedon ndonjë softuer për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave që mblidhen nga departamenti i shërbimeve publike. Gjatë vitit nga ky departament janë mbledhur 683,354€. Të dhënat regjistrohen në mënyrë manuale dhe barten nga viti në vit, duke rrezikuar saktësinë e tyre. Ne, nuk kemi mundur të marrim një bazë ku saktësisht dihet vlera e pagesës dhe obligimeve të shfrytëzuesve të hapësirave. Sipas zyrtarëve në të kaluarën ishte bërë një program për këtë lloj të të hyrave mirëpo ai ka ngecur.
- Rreziku** Regjistrimi i të hyrave në mënyrë manuale, rritë rrezikun e gabimeve dhe vështirëson procesin e gjenerimit të raporteve të detajuara në kohë për menaxhmentin, lidhur me inkasimin dhe llogaritë e arkëtueshme.
- Rekomandimi 8** Kryetari, duhet të sigurojë që sistemi i përshtatshëm i regjistrimit është vënë në funksion për të mbështetur mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave.

## Çështja 9 – Menaxhimi i të hyrave nga hapësirat publike

**E gjetura** Në bazë të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve në pronën publike komunale dhe vendimit të kryetarit për formimin e komisionit për dhënien e pëlqimeve, shfrytëzuesit e hapësirave publike përmes kërkesave të tyre apo inspektimit marrin pëlqimin/refuzimin për shfrytëzim e hapësirave publike. Për të njëjtën ata faturohen me tarifat e sezonit veror/dimëror<sup>10</sup>.

Bazuar në këtë ne kemi gjetur se:

- Komisioni për evidentimin e shfrytëzuesve në sezonin veror është krijuar pas fillimit të këtij sezoni me 19.05.2017, derisa lokalet afariste kanë vazhduar të funksionojnë pa marrjen e pëlqimeve;
- Po ashtu komisioni për sezonin dimëror nuk ishte krijuar fare. Në anën tjetër 30 lokale kishin parashtruar kërkesë për marrjen e pëlqimeve, për të cilat nuk ka pasur përgjigje; dhe
- Edhe pse komisioni për dhënien e pëlqimeve në sezonin veror përbëhet nga pesë anëtarë, ky pëlqim nënshkruhet vetëm nga dy prej tyre. Kjo sipas zyrtarëve për shkak të angazhimeve të shumta të punonjësve dhe se dy nga anëtarët janë inspektorë.

**Rreziku** Ngecja në krijimin e komisioneve me kohë shkakton mos efikasitet në mbledhjen e të hyrave dhe dëmton reputacionin e komunës ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të hapësirave publike si kontribues të buxhetit. Derisa nënshkrimi i vendimit vetëm nga dy anëtarë të komisionit nuk jep siguri në marrjen e vendimeve të arsyeshme.

**Rekomandimi 9** Kryetari, duhet të sigurojë se komisioni për evidentimin e shfrytëzimit të hapësirave publike duhet të bëhet para fillimit të sezoneve, me qëllim të mbarëvajtjes së procesit, dhe mbledhjes së të hyrave në kohën e duhur. Po ashtu pëlqimi të jepet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

### 3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payroll) që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave, nënshkrimin e listave të pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, azhurnimin e dosjeve të personelit si dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Komuna ka filluar të zbatojë harmonizimet në sistem për koeficientët/gradat dhe klasifikimet e pozitive sipas katalogut të punës. Deri tani harmonizimi është bërë për një pjesë të konsiderueshme të stafit.

<sup>10</sup> Sezioni veror përfshin periudhën prill – shtator, sezoni dimëror përfshin periudhën tetor- mars.

---

## Çështja 10 - Klasifikimi i vendeve të punës

- E gjetura** Gjatë rishikimit të disa rasteve ku janë bërë harmonizimet në sistem sipas katalogut të vendeve të punës, kemi konstatuar se nuk është respektuar parimi evropian i dalë nga ky katalog: *Paga e njëjtë për punën e njëjtë*. Tek Qendra për Punë Sociale, kemi vërejtur se për të gjithë zyrtarët që kishin koeficientin 5.5, MAP ka aprovuar koeficientin 6 (grada 10). Mirëpo në një rast, edhe pse zyrtari kishte pozitën e njëjtë sipas koeficientit 5.5, ai është duke u kompensuar me koeficientin 7. Megjithatë, aktemërimi për koeficientin aktual nuk është azhurnuar.
- Rreziku** Diferencat gradime për punën e njëjtë, mund të sjellin demotivim tek punonjësit tjerë të cilët kryejnë punën e njëjtë duke rrezikuar cilësinë e punës dhe shërbimet e ofruara ndaj qytetarëve.
- Rekomandimi 10** Kryetari, duhet të sigurojë se zyra e personelit rishikon të gjitha pozitat e harmonizuara apo edhe ato që do të jenë subjekt ndryshimi në mënyrë që t'i bëjë përditësimet e nevojshme.

## 3.4 Menaxhimi i personelit

Sipas Ligjit Nr.03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës; Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Ligjit mbi të drejtat dhe detyrime Nr.04/L-077 rregullohen çështjet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin dhe organizimin e personelit. Ne kemi evidentuar disa mangësi, si:

---

## Çështja 11 - Angazhimet me marrëveshje për shërbime të veçanta

- E gjetura** Gjatë testimit të Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MSHV) në nëntë raste kemi vërejtur se komuna kishte angazhuar zyrtarët në kryerjen e punëve për periudhën më të gjatë se gjashtë muaj dhe pa procedura përkatëse të rekrutimit. Ky staf ishte angazhuar në pozita të ndryshme si zyrtarë për media, koordinatorë, bashkëpunëtorë, arkitekt, zyrtarë për infrastrukturë, anketues, operatorë, asistent, etj.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave me marrëveshje të përkohshme rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rritë pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi adekuat. Mungesa e konkurrencës së mirëfilltë dhe cilësia e shërbimeve të ofruara mund të jetë e nivelit të dobët dhe objektivat e organizatës të mos arrihen.
- Rekomandimi 11** Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit përmes MSHV-ve angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent dhe periudha e angazhimit të bëhet në kuadër të afateve të parapara me ligj. Ndërsa për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.
-

**Çështja 12 – Tejkalimi i kohës së përcaktuar për mbajtjen pozitive me ushtrues detyre**

**E gjetura** Sipas Ligjit për Shërbimin Civil, neni 30, në rast të pozitive të lira, Ushtruesi i Detyrës (UD) nuk mund të emërohet më gjatë se tre muaj. Në nëntë raste, me pozita menaxhuese, kemi vërejtur se ishin të mbuluara me UD, në një kohë relativisht të gjatë, disa prej të cilëve që nga viti 2015. Po ashtu, edhe zbatimi i rekomandimit mbi azhurnimin e dosjeve të personelit ende mbetet sfidues.

**Rreziku** Mbulimi i pozitive menaxhuese me UD mbi kohën e paraparë, rrit rrezikun që performanca e realizuar dhe përgjegjësia në këto pozita të mos jetë në nivelin e kërkuar. Mos azhurnimi i dosjeve, mund të ndikoj në vlerësime jo reale të stafit dhe mund të ndikoj në shpërndarjen jo racionale të detyrave dhe përgjegjësive brenda insitucionit.

**Rekomandimi 12** Kryetari, duhet të sigurojë që pozitat menaxhuese të mbulohen nga personat kompetent me pozita të rregullta. Në rast të zëvendësimit, kohëzgjatja e funksionit si UD të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar me ligj. Derisa rekomandimi i ripërsëritur lidhur me mirëmbajtjen e dosjeve të adresohet përfundimisht këtë vit.

**3.5 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale**

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe komunalit në vitin 2017 ishte 9,756,454€, kurse buxheti i realizuar ishte 9,611,027 €. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këtë kategori përfshijnë shpenzimet komunale dhe të komunikimit, derivatet dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, mirëmbajtje të rrugëve, dhe shpenzime kontraktuese tjera. Po ashtu nga kjo kategori janë ekzekutuar pagesa direkte nga Thesari, bazuar në nenin 39.2 dhe 40 të LMFP-së.

**Çështja 13 – Dobësitë në planifikim dhe pranim të mallrave**

**E gjetura** Te pagesat e testuara të naftës për ngrohje, si pasojë e planifikimi jo adekuat, komuna ka bërë tejkalim të sasisë së kontratës. Në kontratën kornizë vlera e parashikuar vjetore për derivate të naftës për ngrohje dhe gjenerator është 30,000 litra. Megjithatë, vetëm në dy mostra kemi vërejtur se sasia e pranuar ishte 111,295 litra. Sipas komunës shkak i kësaj është zgjatja e procedurave të prokurimit për aktivitetin e ri si rezultat i ankesave dhe problemeve tjera procedurale.

Po ashtu, përmes kësaj kontrate është bërë pagesa edhe për furnizim me derivate në vlerë 6,930€, pas skadimit të saj<sup>11</sup>.

<sup>11</sup> Dy fatura të datës 06.12.2017 dhe 08.12.2017 në vlerë 6,930€ janë paguar pas skadimit të kontratës më 02.12.2017.

**Rreziku** Anashkalimi i rregullave ka rezultuar me dobësi në pagesat për mallra dhe shërbime. Komuna rrezikon të hyjë në obligime pa mbulesë për shkak të menaxhimit jo efektiv të kontratave dhe mundëson të jetë objekt i padive të cilat mund të rezultojnë me shpenzime shtesë.

**Rekomandimi 13** Kryetari të duhet të forcoj kontrollet në këtë drejtim për të siguruar se janë duke u respektuar rregullat e prokurimit publik dhe është duke u realizuar një mbikqyrje e rregullt në menaxhimin e kontratave. Në një periudhë të pershtatshme kohore para skadimit të kontratave të fillojnë procedurat e prokurimit për të mundësuar lidhjen e kontratave të reja më kohë.

### 3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,916,810€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 1,506,072€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e fermerëve, kompensim të dëmeve të tyre, si dhe mbështetje për aktivitete kulturore dhe sportive, etj.

Përkundër disa përmirësimeve të ndodhura në shpërndarjen dhe menaxhimin e subvencioneve, ende ka mangësi në raportim, të cilat do të dëshmonin destinimin e parave të dhëna.

#### Çështja 14 – Mos raportim nga përfituesit e subvencioneve

**E gjetura** Për subvencionimin e projekteve<sup>12</sup>, komuna nuk ka arritur të mbledhë raporte kthyesë narrative apo financiare/dëshmitë përcjellëse të cilat do të vërtetonin nëse mjetet janë shpenzuar për qëllimin e caktuar.

**Rreziku** Mos raportimi/monitorimi i shpenzimeve të subvencioneve, përveç që mund të shpie në keq përdorim të qëllimit të subvencioneve, lë hapësirë për mungesë të përgjegjësisë nga drejtoritë/programet nga të cilat janë shpenzuar fondet.

**Rekomandimi 14** Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të sigurojë që subvencionet ndahen në përputhje me rregullat duke aplikuar kontrolle shtesë në monitorimin e shpenzimit të fondeve për të siguruar se subvencionet shpenzohen për qëllimin e caktuar. Në këtë aspekt komuna do të rritë kredibilitetin tek qytetarët.

<sup>12</sup> Subvencioni për K.H Prishtina për "Përkrahje për mbarëvajtje të garave" në vlerë 9,950€, për projektin "Medea, ose arti i ekzilit", në vlerë 3,310€ si dhe për projektin "Përgjithmonë Ujku" me 5,000€.

## 3.7 Investimet kapitale

Për vitin 2017, buxheti final i investimeve kapitale ishte 31,486,065€ derisa janë shpenzuar 17,803,525€ apo 57%. Ky realizim paraqet një performancë më të dobët në krahasim me vitin paraprak 2016. Për më tepër, trendi negativ paraqitet që nga viti 2015.

### Çështja 15 – Planifikim i dobët i sasive në kontratë

**E gjetura** Në procesin e tenderimit për projektin “Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës së objekteve shëndetësore dhe sociale” ishte kriter çmimi më i ulët. Oferta fituese me çmimin më të ulët ishte 132,021€. Gjatë ekzekutimit, në disa pozicione janë bërë tejkalime të ndjeshme të sasive, më shumë se që ishin paraparë gjatë planifikimit e që në total sasinë e kontratës janë tejkaluar për mbi 200% (por jo në vlerë totale)<sup>13</sup>. Sipas nenit 5 të UA për kontratat publike kornizë, AK do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e si një prag dhe do të lejojë derivim prej tij plus/minus 30%, dhe nëse urdhërblerjet tejkalojnë atë kontrata duhet të ndërpritet automatikisht.

**Rreziku** Planifikimi jo i përafërt i sasive rrezikon shpërblimin e ofertuesve më të shtrenjtë edhe pse në parim gjatë vlerësimit të ofertave mund të perceptohet sikur po shpërblehet oferta me çmimin më të lirë, dhe si rrjedhojë të shkaktohet humbje financiare për komunën dhe gjithnjë ekziston rreziku i keqpërdorimit gjatë tërë procesit të tenderimit dhe ekzekutimit të një kontrate.

**Rekomandimi 15** Kryetari, duhet të sigurojë se njësitë kërkuese vlerësojnë sa më saktë nevojat për punët që do të porositen në mënyrë që të mos përsëriten rastet e ngjashme. Ne do të sugjerim që me rastin e planifikimit të sasive, një rishikim i tyre të bëhet edhe nga një ekip/staf i dytë që ka njohuri për projektin e caktuar.

<sup>13</sup> Nëse bëhen krahasimet me ofertuesin me çmimin e dytë më të lirë (144,835€), për sasinë e njëjta të punuara, kur komuna pagoi 146,806€, ndërsa sipas ofertuesit të dytë këto sasi do t'i kushtonin Komunës 84,511€. Pra, si rezultat i diskrepancës së lartë të sasive të planifikuara dhe atyre të nevojshme për tu realizuar, ka bërë që ofertuesi më i lirë t'i kushtojë komunës më shtrenjtë, për të paktën 62,2945€.

---

**Çështja 16 - Mangësi në procesin e vlerësimit të tenderëve**

**E gjetura** Në dy dosje të testuara ne kemi vërejtur mangësi gjatë procesit të vlerësimit të tenderit, si:

- Për projektin “Inventarizimi i çerdhes së re në Tophane”, komuna shpërbleu OE me çmimin 57,830€ e jo ofertën më të lirë e cila ishte 47,587€. Komuna vlerësoi se OE me çmimin më të lirë nuk kishte përmbushur kriterin e kërkuar për punë të kryera në furnizim me inventar minimum 50,000€ për tri vitet e fundit. Komuna kishte kërkuar sqarime dhe ky i fundit kishte dërguar dëshmi të mjaftueshme që tregonin se përmbushte këtë kriter megjithatë ishte eliminuar. Kjo pakujdesi e komisionit të vlerësimit i ka kushtuar komunës me një kontratë me çmim më të lartë mbi 10,000€; dhe
- Në dosjen e tenderit “Furnizim me dy autoambulanca për QMU”, tek kërkesat mbi mundësitë teknike/profesionale, është kërkuar që OE të sjellë deklaratën e garancisë nga prodhuesi, për automjete, në kohëzgjatje prej 24 muaj. OE fitues, gjatë kohës së aplikimit, nuk e kishte ofruar deklaratën e garancionit nga prodhuesi, por kishte përgatitur një deklaratë formale të nënshkruar nga vetë kompania. Në raportin e vlerësimit, komisioni kishte konstatuar se OE kishte plotësuar të gjitha kriteret dhe ishte i përgjegjshëm duke e shpallur kështu fitues. Pas pranimit të autoambulancave, OE kishte sjellë dhe garancionin nga prodhuesi.

**Rreziku** Vlerësimi jo i drejtë i ofertave rrezikon që komuna të paguajë çmime jo konkurruese si dhe krijon hapësirë për ofertuesit të shfrytëzojnë të drejtat për ankesë dhe si rrjedhojë të zvarritet realizimi i projekteve. Gjithashtu, vlerësimi i OE si i përgjegjshëm, ndërkohë që nuk kishte plotësuar një kriter të rëndësishëm siç është garancia, rrezikon që OE mos t’ju përmbahet kushteve të kontraktuara.

**Rekomandimi 16** Kryetari, duhet forcojë kontrollet në menaxhimin e procesve të prokurimit për të siguruar se komisionet e vlerësimit bëjnë vlerësim objektiv në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.



---

**Çështja 17 – Lidhja e kontratave në mungesë të zotimit të mjeteve**

**E gjetura** Sipas Rregullës Financiare 01/2013, asnjë kontratë nuk duhet të nënshkruhet pa zotimin paraprak dhe se zotimi duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës. Kontrata për “Rregullimin e parkut afër sallës 1 Tetori” me vlerë 79,376€, ishte nënshkruar pa zotimin paraprak të mjeteve. Zotimi ishte bërë pas pranimit të faturës. Gjithashtu, për kontratën për “Furnizim me dy autoambulanca për QMU” me vlerë 103,996€, zotimi ishte jo i plotë në vlerë prej 50,000€. Zotime të jo të plota ishin gjithashtu edhe tek kontratat si: trajtimi i qenve endacak dhe trajtimi i mbetjeve ndërtimore.

**Rreziku** Nënshkrimi i kontratës në mungesë të zotimit të mjeteve, rrezikon mos përmbushjen e kontratës apo zbatimin e vonshëm të saj dhe në këtë mënyrë mosarritjen e objektivave të komunës.

**Rekomandimi 17** Kryetari, të sigurojë se asnjë kontratë nuk nënshkruhet pa siguruar fondet e nevojshme dhe bërë zotimin për realizimin e saj.

**Çështja 18 - Vonesa në realizimin e kontratave**

**E gjetura** Me rastin e nënshkrimit të kontratave përcaktohet edhe koha e realizimit të tyre. Ne kemi vërejtur se kishte vonesa në projektet si në vijim:

- Procesi i ndërtimit të Bulevardit mbi kurriz, është përcjellë me mangësi të projektuese dhe vonesa të mëdha. Projekti me vlerë 977,725€, për të cilin është nënshkruar kontrata me 12/06/2015 është paraparë të përfundojë pas 180 ditësh, dhe i njëjti nuk është përfunduar ende. Në shtator të vitit 2017 është ndërruar edhe menaxheri i kontratës, për tu zëvendësuar me një menaxher të ri i cili është duke pritur raportin e një komisioni për vlerësimin e punëve të mëparshme, pozicioneve shtesë, dhe me pas të vazhdojë me mbikëqyrje të projektit. Komuna nuk ka aplikuar penale, mirëpo i vetmi ndëshkim ishte tërheqja e vërejtjeve ndaj kompanisë. Po ashtu kompanisë i janë paguar pozicione të gjelbërimit edhe pse nuk kishte siguruar çështjen e ujitjes së tij gjë e cila ka ndikuar në tharjen e shumë drunjëve;
- Sipas kontratës “Furnizim me inventar për administratën komunale”, në vlerë 55,150€, e nënshkruar me 21/11/2016 dhe planit të menaxhimit të kontratës, afati i përmbushjes ishte 45 ditë nga data e nënshkrimit. Furnizimi është bërë me 05/07/2017, përkatësisht shtatë muaj me vonesë. Në ndërkohë, siguria e ekzekutimit kishte skaduar dhe e njëjta nuk ishte ripërtërirë. Sipas menaxherit të kontratës, afati i realizimit të kontratës është shtyrë për shkak të mungesës së hapësirës për vendosje të inventarit nga komuna; dhe

- Në planin e menaxhimit për kontratën “Ndërtimi i rrugës Barilev-Besi” është përcaktuar fillimi i punimeve si dhe kohëzgjatja e tyre në një afat prej 180 ditësh. Kontrata është nënshkruar në tetor 2015, ndërkohë që punët nuk kanë përfunduar ende. Sipas menaxherit të projektit, shkak për vonesën në realizimin e punëve janë problemet me shpronësime të cilat janë vënë në pah pas fillimit të punëve. Kjo si pasojë e nisjes së projekteve pa bërë shpronësimin e tokave që do të jenë pjesë e projektit paraprkisht.

**Rreziku** Vonosat në përfundimin e projekteve reflektojnë në cilësinë dhe dëmtimin e punimeve. Hyrja në obligime kontraktuale pa analizuar mirë nevojat reale dhe kushtet për kryerje të punëve, rrezikon tej zgjatjen e realizimit të projekteve dhe shkakton barrë në buxhetet e viteve vijuese. Mbi të gjitha dëmton reputacionin e komunës.

**Rekomandimi 18** Kryetari, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e projekteve të cilat po përcjellën nëpër vite. Po ashtu duhet të sigurojë se para inicimit të tyre të zgjidhet çështja e shpronësimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik, derisa kontratat për furnizime planifikohen duke u bazuar në nevojat reale dhe kushteve të përshtatshme për realizimin e tyre.

### 3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

#### Çështja 19 - Urdhërblerja pas pranimit të faturës/punëve

**E gjetura** Sipas Rregullës Financiare 01/2013, procesit për inicimin e shpenzimit, i paraprin kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, urdhërblerja, pranimit i mallit dhe më pas fatura. Në 52 pagesa të testuara, që kishin të bënin me investime kapitale si dhe mallra dhe shërbime, nuk janë respektuar rregullat e lartcekura. Urdhërblerja dhe zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të punëve/furnizimeve, gjegjësisht pas pranimit të faturës.

Gjatë testimit gjithashtu kemi hasë në dy pagesa<sup>14</sup> që janë kryer me fatura të pa protokolluara.

<sup>14</sup> Fatura për pastrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shëndetësore me vlerë 21,522€ dhe fatura për derivate nafte me vlerë 38,595.00€

**Rreziku** Hyrja në obligime në mungesë të zotimit të mjeteve/urdhërbljes, mund të shkaktojë rritjen e obligimeve të papaguara dhe si pasojë, ekzekutimin e pagesave direkt nga Thesari. Mos protokollimi i faturave është në kundërshtim me rregullën 01/2013 për shpenzimin e parave publike dhe mbi të gjitha ,rrezikon vlerësimin e drejtë të obligimeve financiare.

**Rekomandimi 19** Kryetari, duhet të sigurojë se, stafi përgjegjës respekton hapat e përcaktuar ligjor mbi procesin e shpenzimeve, ku me rastin e inicimit të shpenzimit, të sigurohet se ekziston zotimi i mjeteve dhe krijimi me kohë i urdhërbljes. Më tutje komuna të sigurojë se mban librin e pranimit të faturave në të cilin protokolohen dhe evidentohet secila faturë e pranuar.

### 3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Në përgjithësi, viteve të fundit, është bërë mjaft progres sa i përket regjistrimit të pasurisë së trashëguar, megjithatë mbetet ende punë për tu bërë dhe koordinim më i theksuar mes disa drejtorive.

#### Çështja 20 – Dobësi në menaxhimin e pasurive

**E gjetura** Dobësitë në menaxhimin e pasurisë ishin si në vijim:

- Sa i përket pasurive kapitale, zyrtari i pasurisë regjistron pasuritë e blera bazuar në dokumentet përkatëse të pagesave të kryera (CPO). Kjo do të thotë se vetëm për blerjet për të cilat është kryer pagesa, prona regjistrohet si pasuri komunale. Por, sipas nenit 10 të Rregullës. 02/2013 të gjitha pasuritë jo financiare, pas pranimit duhet të regjistrohen në regjistra kontabël pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara. Më tej, toka e shpronësuar për interes publik me rastin e ndërtimeve, nuk ishte regjistruar si pasuri. Këtë e ka shkaktuar mungesa e komunikimit ndërmjet drejtorisë së kadastrit me zyrtarin e pasurisë;
- Për arsyen e lartë cekur, gjithashtu njëra nga kabinetat digjitale për shfrytëzim 24/7 për shërbime të gjendjes civile, nuk ishte regjistruar si pasuri komunale. Njësoj, as donacioni nga donatori TIKÀ për restaurimin e Parkut të Qytetit nuk figuron si pasuri komunale. Të dy këto pasuri janë në përdorim;

- Për objektet: 43 banesa komunale të dhëna në shfrytëzim, ish-objekti i gjykatës së Apelit, ish-objekti i gjykatës komunale, ndërtesa ku ndodhet drejtoria e inspeksionit dhe AKP ende nuk është bërë regjistrimi i tyre. Kjo për shkak se komuna është në pritje të një komisioni të jashtëm të nivelit qendror të cilët do të fillojnë vlerësimin e të gjitha pronave;
- Moduli E-pasuria nuk përdoret fare. Stoqet regjistrohen në një regjistër të përgjithshëm të pasurive jo-kapitale në aplikacionin excel. Megjithëse kemi vërejtur se të dhënat janë mjaft të strukturuar në këtë databazë të mirëmbajtur manualisht, megjithatë, ky aplikacion mund të paraqet rrezik të përhershëm për lëshim gabimesh, shlyerje, etj;
- Për mallin e pranuar në vlerë 55,150€ (Furnizim me inventar) si dhe 16,970€ (Furnizim me pajisje IT), nuk ishte caktuar komision për pranimin e mallit. Malli ishte pranuar nga menaxheri i projektit dhe një mbikëqyrës i projektit. Neni 8, pika pesë e rregullores shprehë që Komisioni për Pranimin e Pasurisë jo Financiare duhet të jetë në përbërje të jo më pak se tre anëtarë të fushës përkatëse.

**Rreziku**

Mungesa e informatave të sakta rreth pasurisë, pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Si rrjedhojë e mungesës së regjistrimit të pasurisë, regjistri i tyre është dukshëm i nënvlerësuar, andaj ekziston rreziku i keqpërdorimit të tyre. Në anën tjetër pranimi i mallit në mungesë të komisionit relevant të pranimit, mund të shpie në pranimin e mallit jocilësor dhe jo në përputhje me kushtet e kontraktuara.

**Rekomandimi 20**

Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurive në mënyrë që këtij të fundit t'i ofrohen dokumente të mjaftueshme për regjistrimin e pasurive – me theks, drejtoria e kadastrit, zyra e prokurimit dhe komisionet e pranimit. Me tutje duhet të marrë të gjitha verimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€.

### 3.10 Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet përbëhen kryesisht nga: tatimi në pronë<sup>15</sup>, taksat e ndërtimit, qiratë dhe për shpronësimet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Komuna nuk ka arritur t'i arkëtojë të gjitha të arkëtueshmet për të cilat ka ofruar shërbime, në mungesë të politikave adekuate dhe masave konkrete. Vlera e të arkëtueshmeve në fund të vitit 2017 kishte arritur në 46,116,184€.

#### Çështja 21 – Mungesa e masave konkrete për mbledhjen e te arkëtueshmeve

##### E gjetura

Në menaxhimin e të arkëtueshmeve kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Komuna nuk ka plan apo strategji lidhur me menaxhimin dhe arkëtimin e LL/A<sup>16</sup>;
- Të arkëtueshmet nga taksat e ndërtimit kanë arritur vlerën prej 5,090,868€, kryesisht të arkëtueshme të vjetra të viteve 2012-2015<sup>17</sup>.

Për dhënie të lejeve të ndërtimit komuna kishte pranuar garancionet bankare, mirëpo në asnjë rast të vetëm nuk e kishte shfrytëzuar të drejtën për tërheqjen e garancionit, përkundër faktit që nuk ishin respektuar afatet e pagesës sipas marrëveshjes. Këtë vit drejtoria që merret me këtë çështje ka shfaqur interesim që të angazhojë një përmbarues privat për të inkasuar këto mjete;

- Nga banesat e dhëna me qira, 14 prej tyre nuk i kanë kryer pagesat që rrjedhin nga obligimeve kontraktuale të tyre;
- Komuna nuk është në dijeni se sa është borxhi nga shfrytëzuesit e hapësirave publike për të cilat nuk ka lëshuar faturë gjatë sezonit dimëror, ngase nuk kishte arritur të krijoj komisionin e vlerësimit. Po ashtu nuk dihet as vlera e taksave në biznes dhe nga reklamat<sup>18</sup>.

##### Rreziku

Niveli i lartë i të arkëtueshmeve dhe jo efikasiteti në mbledhjen e tyre mbeten sfidë edhe për periudhën e ardhshme. Mos inkasimi i të arkëtueshmeve rrezikon që ato vjetërsohen dhe të bëhen të pambledhshme duke krijuar një humbje të drejtpërdrejtë financiare për Komunën.

<sup>15</sup> Ende ekzistojnë probleme me gjenerimin e të dhënave të sakta nga programi i tatimit në pronë. ZKA ka publikuar një raport të veçantë për këtë sistem (Pro Tax).

<sup>16</sup> Komuna kishte nënshkruar në vitin 2014 një Letër qëllim, përmes të cilit është përcaktuar plani dinamik i afateve për shlyerjen e borxheve nga AKP, mirëpo kishte dështuar ngase AKP nuk iu kishte përmbajtur.

<sup>17</sup> Prej vitit 2015 e këndej ata që pajisen me leje janë më të rregullt në pagesa.

<sup>18</sup> Referoju çështjes 8

**Rekomandimi 21** Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.

### 3.11 Obligimet e papaguara

Komuna ka deklaruar obligime ndaj furnitorëve vlerën prej 1,262,935€, shumë kjo më e ulët për 26% krahasuar me vitin 2016 (1,696,652€). Derisa në lidhje me pretendimet e palëve tjera ndaj komunës, në bazë të kontesteve aktuale gjyqësore, komuna ka listuar gjithsej 46 raste të mundshme me një shumë të vlerësuar prej 6,180,290€.

Në lidhje me adresimin e rekomandimit për obligimet, komuna ka bërë hap para. Ekziston një raportim i drejtorive tek zyrtari përgjegjës dhe i njëjti ka përmbushur kërkesën e rregullores 02/2013, për raportim mujor tek Thesari. Sidoqoftë, testimet tona kanë identifikuar disa mangësi, të cilat bëjnë që saldo e obligimeve të ndryshojë për një shumë jo materiale, e cila nuk është korrigjuar në PFV.

#### Çështja 22 - Detyrimet kontigjente

**E gjetura** Detyrimet kontingjente të komunës kishin të bëjnë me çështje të ndryshme si pronësore, administrative, banesore penale, kompensim dëmi, etj të ngritura nga palët paditëse të pakënaqura. Vlera e tyre e shpalosur në PFV ishte 6,180,290€ dhe të njëjtat ishin rritur për 1,283,225€ nga viti paraprak. Rritja e tyre dhe humbja e rasteve në gjykata (përmbarues) mund të afektoj buxhetin i cili është planifikuar të shpenzohet në projekte tjera.

**Rreziku** Niveli i lartë i detyrimeve kontigjente mund të përkeqësojë gjendjen financiare të komunës nëse vendimet përfundimtare të gjykatës do të jenë në favor të palëve paditëse.

**Rekomandimi 22** Kryetari, duhet të inicojë një vlerësim të ndikimit financiar që mund të kenë pretendimet dhe paditë, ndaj buxhetit të komunës, dhe të analizojë mundësitë për gjendjen aktuale në lidhje me detyrimet kontigjente.

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të Komunës së Prishtinës ka rezultuar në 26 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Raporti i AP-së, ishte diskutuar në tetor në Kuvendin Komunal, mirëpo nuk ishte diskutuar plani i veprimit për zbatim të rekomandimeve. Aktualisht komuna përmes ndihmës së një projekti të USAID është duke punuar rreth mundësisë së zbatimit të rekomandimeve të AP-së.

Deri në fund të auditimit tonë nga rekomandimet e dhëna për vitin 2016, shtatë rekomandime janë zbatuar, shtatë ishin në proces dhe 12 nuk janë adresuar ende. Nga viti 2015 ishin bartur 17 rekomandime (tetë të pa zbatuara dhe nëntë të tjera ishin në zbatim e sipër). Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

### Çështja 23 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

**E gjetura** Mungesa e një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së, ka ndikuar që një numër i vogël i rekomandimeve të janë zbatuar plotësisht, ndërsa pjesa më e madhe e tyre janë në proces të zbatimit ose të pa zbatuara, përfshirë këtu edhe rekomandimet nga vitet e mëhershme. Komuna, nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së.

Rekomandimet e pa zbatuara, e të cilat po përsëriten në vazhdimësi kanë të bëjnë me: nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit, keq-klasifikimin e shpenzimeve, regjistrat e pasurive jo të plotë, mungesa e regjistrat të rreziqeve, performanca e dobët e NJAB-së, mos kryerja e obligimeve nga shfrytëzuesit e banesave të komunës (qiramarrësit), raportimi jo i plotë i obligimeve, si dhe mos verifikimi i 1/3-tës së pronave komunale.

**Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe financiare kanë rezultuar në:

- Parregullsi në ekzekutimin e pagesave dhe klasifikimin e shpenzimeve;
- Mosfunksionim i NJAB-së; dhe
- Dobësi në menaxhimin e të hyrave dhe LI/A.

**Rekomandimi 23** Kryetari, duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerri veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në lidhje me qeverisjen e mirë vlerësojmë progresin që ka bërë komuna në lidhje me plotësimin dhe dorëzimin e pyetësorit të vet-vlerësimit, i cila vitin e kaluar nuk ishte plotësuar fare. Megjithatë, ekzistojnë disa mangësi sa i përket qeverisjes brenda komunës, veçanërisht në lidhje me mos zbatimin e plotë të rekomandimeve nga viti paraprak, anashkalimin e planit për menaxhimin e rrezikut, mungesë iniciativash konkrete në rritjen e të hyrave dhe mos efikasiteti i auditimit të brendshëm si katalizator i efikasitetit të kontroleve të brendshme.

Sipas Ligjit për planifikimin hapësinor planifikimi i nivelit lokal bëhet përmes tri dokumenteve: Plani Zhvillimor Komunal; Harta Zonale e Komunës; dhe planet Rregulluese të Hollësishme.

Komuna gjatë vitit 2017 kishte Planin Zhvillimor Komunal 2012-2022, mirëpo i njëjti nuk kishte të llogaritur ndonjë kosto për zbatimin e tij dhe nuk është i përcaktuar ndonjë afat për arritje të objektivave apo monitorim të tyre. Vlerësimi i kësaj strategjie ishte bërë vetëm në mënyrë joformale.

Aktualisht komuna ka bërë përgatitjet për hartimin e hartës zonale si dokument fillestar për krijimin e strategjisë, pas së cilës do të krijohet Plani i ri Zhvillimor Komunal.

Po ashtu në këtë fazë komuna ka hartuar tri plane të hollësishme rregulluese: plani rregullues i hollësishëm për blloqet "B17", "B18", "B19" dhe "B20", ai për tërësinë Urbane "B" të lagjes Prishtina e re dhe plani rregullues për "Sofalia 2016-2024".



## 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me katër anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe tre auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

### Çështja 24 - Funkzionimi i dobët i NjAB-së

**E gjetura** Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së, si:

- Përkundër rekomandimit të dhënë dhe zotimit të menaxhmentit për funksionalizimin e NjAB-së, kjo njësi pothuajse është jo funksionale edhe gjatë vitit 2017. Ata gjatë gjithë vitit kishin finalizuar vetëm një raport të auditimit lidhur me procesin e menaxhimit të hyrave në “Bibliotekën Hivzi Sylejmani”, si dhe tri auditime ishin në proces, të cilat kishin filluar me kërkesë të menaxhmentit. Auditimet në proces kishin të njëjtin fokus dhe kishin të bënin me “Teatrin Dodona”, “Arkivin Komunal” dhe në “Qendrën Kulturore të Fëmijëve të Komunës së Prishtinës”;
- NjAB, nuk kishte përpiluar statutin për NjAB-në. Gjatë vitit 2017 nuk ishte themeluar Komiteti i Auditimit (KA), i cili do ta mbështeste menaxhmentin në përmirësimin e kontrollit të brendshëm, duke siguruar pavarësinë e NjAB-së, mbikëqyrjen e planeve dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Komiteti është themeluar në vitin 2018; dhe
- Plani strategjik dhe Plani vjetor i punës ishin përgatitur por nuk ishin aprovuar dhe nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

Këto rezultate tregojnë jo gatishmëri në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm ose për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme. Kjo, gjithashtu, tregon cilësi të dobët të planifikimit të auditimit të brendshëm.

### Rreziku

Mosfunksionimi adekuat i NjAB-së ndikon që niveli i kontrolleve të brendshme të mos përmirësohet dhe rrezikon që gabimet dhe mangësitë e njëjta të vazhdojnë të përsëriten. Derisa si pasojë e mos funksionimit të KA-së shkaktohet mungesa e sigurisë dhe këshillave që i ofrohen menaxhmentit në lidhje me rreziqet, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimit. Në veçanti kjo mund të rezultojë me mangësi në realizimin e planeve të NjAB-së dhe zvogëlon sigurinë se rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar.

**Rekomandimi 24** Kryetari, në bashkëpunim me kryesuesin e KA-së dhe Drejtorin e NJAB-së duhet të analizojnë situatën aktuale dhe të sigurojë funksionimin normal të aktiviteteve të auditimit të brendshëm komfor kërkesave ligjore me qëllim të arritjes së objektivave. Hapat e parë duhet të jenë aprovimi i statutit dhe planeve të NJAB-së, ndërsa me pas përmes një komiteti efektiv të ndihmojnë aktivitetet operative në vazhdim, më fokus në adresimin e rekomandimeve, në mënyrë që përfitimet nga auditimi i brendshëm të jenë sa më të larta.

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosja e rezultateve në mënyrë transparente.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të mangëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

### Çështja 25 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

**E gjetura** Si pasojë e kontrolleve jo të mira menaxheriale, shuma të konsiderueshme të buxhetit për investime kapitale nuk janë shpenzuar dhe numër i madh i pagesave janë ekzekutuar direkt nga Thesari. Po ashtu menaxhimi i prokurimit dhe të hyrave nuk ishte në nivelin e duhur. Menaxhmenti duhet të bëjë analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, të rishqyrton planin e prokurimit, arkëtimin e të hyrave si dhe obligimeve të saj.

Në anën tjetër, komuna nuk ka ndonjë regjistër të rreziqeve të hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe as që përgatitet ndonjë raport për menaxhimin e tyre.

**Rreziku** Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar duhet të forcohen për të ndikuar në efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë.

**Rekomandimi 25** Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim	<p>Prioritet i lartë - Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për mos adresimin e rrezikut domethënës lidhur me plotësinë e pasurive, si dhe keq-klasifikimin e shpenzimeve dhe pagesat në llogari të donatorëve që ka rezultuar me Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të siguruar një vlerësim të saktë të pasurive kapitale. Ky proces duhet të monitorohet formalisht nga Kryetari i Komunës.</p> <p>Prioritet i lartë - Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, para se në draft PVF të jenë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>			Nuk janë marrë masa.
2.2 Qeverisja	Për t'iu shmangur situatave të tilla, Kryetari duhet të forcoj kontrollet dhe të siguroj se departamenti i financave posedon të gjitha evidencat mbi detyrimet. Pagesa e detyrimeve të prapa mbetura, duhet të trajtohet me prioritet me rastin e planifikimeve buxhetore, si dhe të forcoj disiplinën financiare dhe të paguaj me kohë të gjitha faturat.			Nuk janë marrë masa.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse plani i veprimit për vitin e kaluar nuk është dorëzuar në ZAP dhe pse rekomandimet e auditimit nuk janë zbatuar. Ne rekomandojmë që hartimi i planit të veprimit për vitin 2015 të bëhet me kohë dhe të përcaktoj saktë afatet kohore për adresim të rekomandimeve, të përcaktoj stafin përgjegjës, me fokus fillestar në çështjet më të rëndësishme të ngritura nga auditimi.		Plani i veprimit është dorëzuar, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve është shumë i ulët.	
2.5 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se në bashkëpunim me ekipin e tij menaxhues do të diskutoj dhe identifikoj rreziqet e nivelit të lartë në të gjithë sektorët e komunës, të përcaktoj masat dhe veprimet parandaluese, si dhe të delegoj përgjegjësitë për menaxhimin e rrezikut te stafi përkatës. Gjithashtu, duhet të sigurojë raportime dhe shqyrtime të rregullta për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.		Në proces, ka një formë të raportimit mirëpo raportohen vetëm aktivitetet mujore të departamenteve.	
2.6 Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se funksioni i auditimit të brendshëm do të fuqizohet dhe materializohet me trajtimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe ofrimin e sigurisë së arsyeshme se kontrollet operojnë në mënyrë efektive dhe ashtu siç janë dizajnuar. Në funksion të maksimizimit të përfitimeve nga auditimi i brendshëm, ne sugjerojmë edhe themelimin e Komitetit të Auditimit brenda një afati të arsyeshëm.		Ne proces, është krijuar komiteti, mirëpo edhe më tutje nuk funksionon mirë kjo njësi	

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore rishikohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivele të planifikuara. Këtij aktiviteti duhet t'i paraprijë një proces i mirëfilltë i planifikimit, përcaktimit të objektivave dhe ndërlidhjes së tyre me buxhetin e komunës.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të analizoj arsyet e mos realizimit të hyrave dhe trendin e të hyrave gjatë viteve të fundit dhe në bazë të kësaj të bëjë një planifikim objektiv dhe të realizueshëm. Më tej, i njëjti plan duhet të pasohet me aktivitete dhe masa adekuate për zbatim.		Në proces/janë marrë disa iniciativa për krijim të softverit për të hyra.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të siguroj se përdorimi i fondeve të bëhet në përputhje me ndarjet fillestare të buxhetit, dhe në rast të devijimeve të tilla, shpenzimet duhet të prezantohen dhe shpalosen në përputhje me kërkesat ligjore duke ofruar një transparencë të plotë për përdoruesit e pasqyrave financiare.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurim	Kryetari duhet të siguroj masat e duhura për respektimin e rregullave të prokurimit publik dhe të ushtrojë mbikëqyrje të përshtatshme për menaxhim cilësor të kontratave.		Në proces/ por ende ka mangësi tek prokurimi si vlerësimi i tenderëve, tejkalimi i kontratave dhe tjera.	

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë që kjo praktikë të mos përsëritet me rastin e marrëveshjeve të reja, ndërsa për marrëveshjet në implementim e sipër, të forcohen kontrollet, sidomos në kërkesën e raporteve periodike nga partnerët për progresin e arritur kundrejt fondeve të shpenzuara. Në aranzhimet vijuese, për të gjitha projektet e ngjashme, komuna duhet të merr rolin e autoritetit kontraktues, dhe t'i udhëheq vet të gjitha procedurat që nga inicimi deri në përfundimin e projekteve. Komuna duhet të përgatit raportet përfundimtare për realizimin e projekteve të financuara deri tani, dhe në auditimin e radhës, ato do të jenë pjesë e veçantë e rishikimeve.		Në proces/ ka pasur kërkesa për raportim në lidhje me mjetet e transferuara megjithatë si fenomen është përsëritur edhe këtë vit.	
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet t'i rishikojë nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta. Nevoja për staf shtesë për pozitat e karrierës duhet të analizohet dhe nëse rritja e numrit të stafit është e domosdoshme, kjo të inkorporohet edhe në planifikimet buxhetore. Barrierat eventuale lidhur me rritjen e stafit, duhet të diskutohen edhe me Ministrinë e Financave dhe akterët tjerë.		Në proces/ numri është reduktuar.	
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet të sigurojë që zyra e personelit do të aplikoj të gjitha kërkesat e rregulloreve të shërbimit civil për kompletimin e dosjeve, duke përfshirë edhe vlerësimet e rregullta të performancës për gjithë stafin.		Në proces, kanë filluar të kompletohen dosjet.	
3.5.3 Subvencionet	Kryetari duhet të siguroj se rregullorja aktuale për subvencionet do të ndryshohet dhe plotësohet në pjesët ku janë identifikuar paqartësitë dhe të përcaktohen kriteret, kërkesat, procedurat dhe dokumentet e duhura për ndarjen dhe kontrollin e fondeve të dhëna për subvencione.		Në proces, është në hartim e sipër rregullorja e re.	



3.6 Të hyrat	Kryetari duhet t'i analizoj rastet e përmendura më sipër dhe të vendos kontrollet e duhura, që të gjitha pronat e dhëna me qira, të monitorohen në kuptimin e pagesës së qirasë në baza të rregullta mujore.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari duhet të rishikoj kontrollet dhe të aplikoj aktivitete shtesë për ekzekutimin e garancioneve sipas marrëveshjes, me qëllim që inkasimi i të hyrave të bëhet me kohë.		Në proces, rastet do të shkojnë tek përmbaruesit.	
	Kryetari duhet të vendos kontrolle mbi verifikimin e pronave, ndryshimet të përcillen në kohë dhe ngarkesat për tatimpaguesit të jenë të sakta, me qëllim të realizimit korrekt të tatimit në pronë.			Nuk janë marrë masa.
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollet lidhur me menaxhimin e pasurive dhe të sigurojë regjistrim të saktë dhe të plotë të tyre. Çështja e pasurive të identifikuar, por të pa regjistruara në SIMFK, duhet të diskutohet me Ministrinë e Financave dhe të gjinden modalitetet për përfshirjen e tyre në sistem.		Në proces/vlera e pasurive të paregjistruara është dukshëm më e vogël.	
3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet t'i analizojë arsyet e trendit të rritjes së këtyre llogarive dhe t'i forcojë kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtutjeshme. Një strategji dhe mekanizma adekuat duhet të vendosen për të mundësuar identifikimin dhe arkëtimin e borxheve të akumuluar, përfshirë edhe veprimet ligjore.			Nuk janë marrë masa.
3.7.3 Trajtimi i borxheve (detyrimeve)	Kryetari duhet të siguroj veprime konkrete që departamenti i financave të evidentoj dhe paguaj me kohë të gjitha detyrimet, ndërsa detyrimet kontingjente të trajtohen me kujdes me rastin e planifikimeve të ardhme buxhetore.		Në proces- është zvogëluar numri i gabimeve.	

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.Pasqyrat Financiare	<p>Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i adresuar shkaqet në Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Procesi buxhetor duhet të jetë reflektim i shpenzimeve reale në mënyrë që të gjitha shpenzimet të klasifikohen sipas kodeve adekuate. Sa i përket institucioneve vartëse, ne do të inkurajonim të bëhet nga një auditim i brendshëm për të marrë siguri të mjaftueshme rreth mënyrës së mbledhjes së të hyrave dhe krijimit të shpenzimeve, të paktën për dy vitet paraprake.</p> <p>Kryetari duhet të siguroj se gjendet një zgjidhje e përshtatshme për plotësimin e pozitës së ZKF-së. Gjithashtu, para se pasqyrat të dërgohen në MF, ato t'i nënshtrohen një rishikimi gjithëpërfshirës në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e tyre, me theks të veçantë tek evidentimi dhe regjistrimi i palëve të treta si dhe llogarive të arkëtueshme nga taksat në biznes.</p>			Nuk janë marrë masa.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse një numër rekomandimesh nga viti i kaluar nuk janë zbatuar, si dhe të sigurojë që plani i veprimit i përgatitur pas marrjes së këtij raporti, do të inkorporoj të gjitha rekomandimet e dhëna dhe do të përcaktoj saktë afatet kohore, masat dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu, kryetari, duhet të zbatoj masa përgjegjësie ndaj personave të ngarkuar për zbatimin e masave përmirësuese të proceseve, për çështjet e ngritura nga auditimi.			Nuk janë marrë masa.
2.2 Pyetësori i vetëvlerësimit	Komuna e Prishtinës nuk ka arritur të përmbushë obligimin për plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit dhe dorëzimin e tij në MF	Po		
2.3.1 Planet dhe objektivat strategjike	Kryetari i Komunës duhet të sigurohet që si planet strategjike, ashtu edhe ato operative, përmbajnë objektiva të qarta dhe janë në harmoni me vizionin dhe politikën e qeverisjes së përgjithshme komunale. Kjo do të mundësonte vlerësim të drejtë të rezultateve dhe rishikim të objektivave departamentale, aty ku është e nevojshme.		Në proces, është krijuar grupi për hartën zonale	

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të siguroj se raportimi nga drejtuesit e departamenteve komunale është i mjaftueshëm, cilësor dhe me kohë, në mënyrë që të rritë aftësinë vendimmarrëse dhe të reagimit me kohë ndaj situatave të cilat mund të kërcënojnë mbarëvajtjen e aktiviteteve financiare dhe operative të komunës.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Sistemi i Auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimet maksimale nga auditimi i brendshëm, kryetari duhet të merr masa të menjëhershme që të zgjidhë problemin e funksionimit të plotë të NJAB, ndërkohë që përfitimet nga këto shërbime janë minimale dhe gati pa kurrfarë ndikimi.		Në proces, NjAB nuk është funksionale mirëpo është krijuar komiteti i auditimit.	
3.1 Realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të bëj një analizë gjithëpërfshirëse të shkaqeve dhe arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale në 2016 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në 2017.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Edhe pse këtë vit është vërejtur një angazhim i Drejtorisë së Kulturës për të rregulluar dhe futur në sistem menaxhimin financiar të këtyre dy njësive, megjithatë, Kryetari duhet të veproj në drejtim të arritjes së këtij qëllimi. Gjithashtu, ne do të inkurajonim të bëhet një auditim i brendshëm për secilin Institucion, për të marrë siguri të mjaftueshme rreth mënyrës së mbledhjes së të hyrave dhe shpenzimeve, për dy vitet paraprake	Po		
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të inicoj vendosjen e procedurave me Agjencinë e Regjistrimit Civil në mënyrë që të krijohet një formë e përshtatshme harmonizimi midis formularëve të lëshuar dhe barazimeve me mbikëqyrësit, në mënyrë që të lihen gjurmë adekuate dhe të lehta për monitorimin e të hyrave të arkëtuara. Më tej, të sigurojë se barazimet ndër departamentale kryhen në baza të rregullta mujore dhe të gjitha mospërputhjet sqarohen me kohë.	Po		

3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se Drejtoria e Urbanizimit dhe Sektori i tatimit në pronë komunikojnë efektivisht në mënyrë që të gjithë të legalizuarit për objektet ndërtimore, paguajnë njëkohësisht edhe vlerën e saktë të tatimit në pronë konform sipërfaqeve të verifikuara përmes dosjeve për legalizim. Kjo do të lehtësonte në një masë edhe procesin e verifikimit të pronave për tatimin në pronë		Në proces, ka përmirësim megjithëse nuk po arrihet të bëhet verifikimi i 1/3 te pronave	
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që zyrtarët e ngarkuar me menaxhimin e pronave komunale të ndërmarrin të gjitha mjetet juridike për inkasim të tarifave të përcaktuara me kontratë, ndërsa komisioni për evidentimin e shfrytëzimit të hapësirave publike duhet të bëhet para fillimit të sezonës verore			Nuk janë marrë masa.
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari të siguroj se ekzekutimi i vendimeve të tilla bëhet me kohë në mënyrë që të shmangen humbjet e buxhetit komunal. Gjithashtu, dosjet e personelit të përmbajnë dokumentet e kërkuara dhe të aprovuara nga menaxhmenti i lartë i komunës dhe të aplikohet sistemi i vlerësimit të performancës për stafin komunal.		Në proces/ dosjet janë në proces të kompletimit.	
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet (përfshirë shpenzimet komunale)	Kryetari duhet të shtojë kontrollet ndaj menaxhimit të kërkesave për shërbimet e domosdoshme të komunës në mënyrë që t'i siguroj me kohë këto shërbime. Po ashtu, me rastin e planifikimeve buxhetore, zyra ligjore duhet të shqyrtoj me kujdes të gjitha detyrimet e prapambetura të komunës dhe të vlerësoj shumat e mundshme të daljes së parasë nga kontestet e hapura gjyqësore, dhe të njëjtat të përfshihen në kuadër të buxhetit vjetor. Për rastin e sigurimit të automjeteve, komuna të rishikoj pagesat e bëra ndaj OE dhe të ndërmerr veprimet e duhura për kthimin e mjeteve			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet (përfshirë shpenzimet komunale)	Kryetari duhet të sigurohet që vendimi dhe çmimet e paguara kanë mbështetje ligjore, dhe nëse jo të iniciojë bisedimet me Ministrinë në mënyrë që furnizimeve të tilla t'i paraprijnë procedura të hapura prokurimi.	Po		


3.1.3 Mallrat dhe shërbimet (përfshirë shpenzimet komunale)	Kryetari duhet t'i rishikojë nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta. Nevoja për staf shtesë për pozitat e karrierës duhet të analizohet dhe nëse rritja e numrit të stafit është e domosdoshme, kjo të inkorporohet edhe në planifikimet buxhetore. Barrierat eventuale lidhur me rritjen e stafit, duhet të diskutohen edhe me Ministrinë e Financave		Në proces, numri i tyre është në rënie.	
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet (përfshirë shpenzimet komunale)	Kryetari duhet të siguroj masat e duhura për respektimin e rregullave të prokurimit publik dhe inicimi i procedurave të prokurimit të aprovohet sipas rregulloreve të prokurimit dhe të mos ndodhin furnizime jashtë kontratave.	Po		
3.1.4 Subvencionet	Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet në atë mënyrë që për çdo subvencion të dhënë merren dëshmi të mjaftueshme dhe relevante që vërtetojnë se subvencioni është shpenzuar sipas qëllimit të caktuar		Në proces, rregullorja është diskutuar në Kuvend.	
3.1.5 Investimet Kapitale	Kryetari duhet të siguroj se ndryshimet/ridestinimet në projektet kapitale të komunës të prezantuara në Tabelën e buxhetit 4.2 "Financimi i projekteve kapitale" të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal, ashtu siç e parasheh ligji.			Nuk janë marrë masa.
3.1.5 Investimet Kapitale	Kryetari duhet të siguroj që menaxherët e kontratës dhe çertifikuesi i pagesave, do të sigurojnë raporte të plota lidhur me pranimin e shërbimeve, dhe vetëm pasi të jetë konfirmuar se shërbimet janë pranuar në sasinë dhe cilësinë e duhur, pagesat të çertifikohen	Po		
3.1.5 Investimet Kapitale	Kryetari duhet të siguroj që kontratat nuk nënshkruhen pa sigurimin paraprak të fondeve. Gjithashtu, urdhërblerja të krijohet dhe përgatitet pas zgjedhjes së ofertuesit me të cilin është nënshkruar kontrata			Nuk janë marrë masa.

3.1.5 Investimet Kapitale	Kryetari duhet të konsideroj se marrëveshjet për projektet e bashkë financuara do të kenë një siguri për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, përfshirë kërkesat e qarta të raportimit gjatë implementimit dhe monitorimit të projektit para se të bëhen transferet e mjeteve.		Në proces	
3.1.5 Investimet Kapitale	Kryetari duhet të siguroj që zyra e prokurimit para inicimit të procedurave të prokurimit të rishikojë kërkesën e njësisë kërkuese dhe aty ku nuk është kërkesa e përshtatshme, ta kthej tek njësia kërkuese për rishikim, në mënyrë që kërkesat të jenë të matshme dhe të pranueshme për furnizimet.	Po		
3.2 Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj bashkëpunimin e drejtorive për informimin e përvetësimeve të pasurive të reja, që zyrtari i pasurisë të ketë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin në SIMFK. Duhet funksionalizuar moduli e-pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€ si dhe evidentimi i stokeve, përfshirë të gjithë sektorët.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj se për të arkëtueshmet e taksave në biznes krijohet një grup pune që në hollësi do të analizonte gjendjen e këtyre llogarive, ku do të shqyrtonte evidentimin, faturimin dhe mekanizmat e inkasimit në mënyrë që në të ardhmen komuna të ketë bazë të mjaftueshme ligjore për ndjekje të bizneseve të papërgjegjshme në pagesën e kësaj takse. Mangësitë e identifikuar në sistemin e tatimit në pronë të diskutohen me departamentin përkatës pranë MF në mënyrë që qytetarët të kenë një gjendje të saktë për obligimet tatimore ndaj komunës.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Obligimet e Papaguara	Kryetari duhet të vendos një sistem të protokolimit të çdo fature të pranuar nga operatorët. Po ashtu, të siguroj se konfirmimet formale për faturat e papaguara bëhen nga departamentet përgjegjëse ndaj kërkesave të ZKF-së.			Nuk janë marrë masa.

## Shtojca III: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/ jo	Komentet e OB-së në rast të mos pajtimit	Pikëpamjet e ZKA-së
Çështja 13	Jo	<p>Tejkalimi i sasive të naftës të parapara me kontratë është sqaruar edhe në vitin paraprak e edhe gjatë auditimit të kryer këtë vit, por për korrektësi i paraqesim edhe njëherë sqarimet tona në pika të shkurta;</p> <p>Kontrata për të cilën bëhet fjalë është kontrate e vitit 2014 (nënshkruar me 02.12.2014), që d.t.th. në kohën kur nuk ka ekzistuar asnjë kufizim sasi or as monetar për nivelin e shfrytëzimit të kontratave kornizë. Ua përkujtoj se në pikën 1.4 të Kushteve të përgjithshme të kontratës e që është pjesë e dosjes së tenderit shkruan: Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blej ndonjërin prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë mund të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të vlerësuara për çdo artikull, p.sh. brenda një pjese (LOTI) të njëjtë. Megjithatë Autoriteti Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është i detyruar të përdorë këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojë mallëra të përmendura në pikën 1.1. Kufizimet lidhur me shfrytëzimin e kontratave kornizë janë aprovuar me Udhëzimin Administrativ numër 2/2015 të datës 10.03.2015, me të cilin është kufizua shfrytëzimi i kontratës në plus/minus 30%. Shfrytëzimi i kësaj kontrate për furnizim të shkollave është bërë bazuar në faktin se aktiviteti tjetër i zhvilluar për furnizim me naftë të shkollave është anuluar për shkak të ankesave dhe problemeve tjera me cilësinë e naftës, për të cilën tani me ka një Vendim Gjyqësor (për OE-ik "Hib Petrol"). Kontrata është shfrytëzuar deri në afatin e paraparë në kontratë, pasi që gati deri në atë afat nuk ka pasë as kontratë nga AQP-ja, për të cilën është dashtë të presim kohë të gjatë për shkak të ankesave në OSHP dhe pas kontraktimit nga ana e tyre, nga data 02.12.2017 furnizimet me naftë i bëjmë nga ajo kontratë.</p> <p>Lidhur me pagesën pas skadimit të kontratës, ju sqaroj se furnizimet janë kryer para skadimit të kontratës dhe nuk ka asnjë kufizim ligjor për realizim të pagesës pas skadimit të kontratës.</p>	<p>Rekomandimi ynë qëndron, gjetja trajton fenomenin e planifikimit të dobët nga ana e autoritetit ku vetëm në dy pagesa të testuara, është tejkaluar sasia indikative (e caktuar në kontratë) për 270%. Kjo ka sjellur implikime buxhetore ku nga mostrimi ynë kemi vërejtur që ka shpikë në keqklasifikim të disa pagesave të bëra për naftë.</p> <p>Ndërsa sa i përket pretendimit për furnizim para skadimit të kontratës, dëshmitë tregojnë se urdhërblerja/porosia e mallit si dhe fletdërgesa janë pas skadimit të kontratës (referojnë fusnotën nr. 11 të këtij raporti).</p>

## Shtojca IV: Letër konfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe komentet i keni të bashkëngjitura për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Shpend Ahmeti

Kryetar i Komunës së Prishtinës



Data: 24.05.2018

Prishtinë,